**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER TERENS N. KURTI**
**ADRESA NR.10, KONT URANI, NR.2/28**
**TEL: 692055033**

# VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

**Nr. repertori: 739** **Nr. koleksioni: 233**

**Tirane më 07/06/2022**

Ligjet referuese

1 Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2 Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2022052670025415054

A2022052670025415054

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**

*Noteri "Kurti" since 1986. Terens Kurti, Tiranë rruga "Durrësit", Kont Urani Nr.1, (mbrapa Ministrisë së Arsimit).*

NR.7_1 REP.
NR.2_5 KOL

## DËSHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

Sot me datë 21/06/2022 (dymijë e njëzet e dy), ditën martë, para meje Noterit **Terens N. Kurti, NUIS L42109015A**, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, rruga "Kont Urani", Nr.1, mu paraqit:

KËRKUESE: **VIOLA TERZIU**, atësia Vasillaq, amësia Irena, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banues në "Tiranë, Rruga Ndre Mjeda; Nd. 35; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 14/05/1981, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032879103 dhe nr. personal I15514044D.

OBJEKTI : Lëshimi i Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për trashëgimlënësin **ERVIN TERZIU**, me atësi Xhemali dhe amësi Fatbardha, me ID H60816051W.

BAZA LIGJORE : Nenet 316, 317, 318, 320, 348, 360, e vijues të Kodit Civil të Republikës se Shqipërisë,i ndryshuar; neni 62, pika 1, gërma d, nenet 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar.

Une Noteri Terens N. Kurti, Anëtar i Dhomës së Noterisë, Dega Vendore Tiranë, pasi u njoha me Kërkesën me objekt *"Lëshimi i Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore"* dhe pasi mora në shqyrtim provat e paraqitura:

### KONSTATOVA:

*Legjitimiteti Kërkueses:* Kërkuesja është bashkëshortja e Trashëgimlënësit, dhe legjitimohet në paraqitjen e Kërkesës për Çeljen e Dëshmisë së Trashëgimisë, pasi bën pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjore të rradhës së parë ligjore, së bashku me të tjerë.

*Juridiksioni:* Kërkesa i përket juridiksionit të Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë, sipas Kthim Përgjigjes kerkeses Nr.1325-76 datë 03.06.2022; Çertifkata e vdekjes së Trashëgimlënëses lëshuar nga Njësia Administrative 7 379, Bashkia Tiranë.

*Çelja e Trashëgimisë:* Koha e vdekjes së trashëgimlënësit, përfaqëson edhe kohën e çeljes së trashëgimisë. Ne lidhje me themelin e kërkimit, Noteri e konsideron të domosdoshme, vërtetimin paraprakisht të faktit të vdekjes se trashëgimlënësit dhe kohës së vdekjes së tij. Me çastin e çeljes së trashëgimisë lidhet edhe fillimi i ecjes së të gjitha afateve që lidhen me trashëgiminë: *për heqjen dorë nga trashëgimia, për kërkimin e trashëgimisë për sende të veçanta, etj.* Vdekja e Trashëgimlënësit shërben si fakt juridik, me të cilin ligji, lidh lindjen e marrëdhënies juridike të trashëgimisë *mortis causa*, që lind për shkak dhe pas vdekjes së trashëgimlënësit. Me vdekjen e trashëgimlënësit, të gjitha të drejtat pasurore të tij kalojnë tek trashegimtarët në bazë ligjit.

*Ligji material i zbatueshëm:* Koha e vdekjes së trashëgimlënësit është përcaktuese në lidhje me ligjin material të aplikueshëm për rregullimin e marrëdhënies juridike të trashëgimisë. Nga çertifikata e

vdekjes, vërtetohet se Trashëgimlënësi është ndarë nga jeta në datën *13.12.2021 (dymijë e njëzetë e një)*.

Nga verifikimi i bërë në lidhje me ligjet në fuqi në kohën e vdekjes së Trashëgimlënësit, do të zbatohet *Ligji Kodi Civil i miratuar në vitin 1994*.

*Cilësia Trashëgimtar* : Cilësia trashëgimtar dhe pjesët takuese, do të përcaktohen nga ligji material në fuqi në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Me datë *13.12.2021 (dymijë e njëzetë e një)*, ka vdekur Trashëgimlënësi **ERVIN TERZIU,** me atësi Xhemali dhe amësi Fatbardha, lindur në Tiranë më datë 16.08.1976, me vendbanim të fundit të rregjistruar në *"Tiranë, Rruga Ndre Mjeda, Nd.35, H.2, Njesia Administrative Nr.7; 1023"*, me shtetësi Shqiptare, mashkull, me numer personal ID H60816051W, me status i martuar me Nr.10 Akti më datë 04.02.2014 deri më datë 13.12.2021, me shtetasen bashkëshorten VIOLA TERZIU, me atësi Vasillaq, vërtetuar me Certifikaten e Martesës Nr.000267646 datë 20.05.2022 vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Njesia Administrative Nr.7.

Nga verifikimi i Çertifikatave, vërtetohet se në kohën e vdekjes së Trashëgimlënësit, personat e rregjistruar në trungun familjar: Çertifikatë Familjare V.1974 (017877396) lëshuar më datë 30.05.2022 nga ZGJC (arkiva) Tiranë; Çertifikatë Familjare V.2010 (17877395; 017877397) lëshuar nga Zgjc 10 382, Bashkia Tiranë me dt. 30.05.2022, Çertifikatë Familjare V.2010 (017765027) lëshuar nga Zgjc 10 382, Bashkia Tiranë me dt. 26.05.2022; që përbëjnë trashëgimtarët e rradhës së parë ligjore janë:

*Bashkëshortja* — **VIOLA TERZIU**, atësia Vasillaq, amësia Irena, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë, me vendbanim në "Tiranë, Rruga Ndre Mjeda; Nd. 35; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023" lindur më 14/05/1981, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me ID nr. personal I15514044D. *(e gjallë)*.

*Djali* — **ANDRE TERZIU**, me atësi Ervin dhe amësi Viola, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më datë 10.12.2013, me vendbanim në "Tiranë, Rruga Ndre Mjeda; Nd. 35; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023", mashkull, me ID Nr. Personal L31210063A. *(i gjallë)*.

Nga dokumentat e depozituara nga Kërkuesi në Zyrën e Noterit *(Certifikatë vdekje; Martese; familjare; personale, dhënia e pëlqimit për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë nga Dhoma Kombëtare e Noterise, shpjegimet/ deklarimet e Kërkuesit)*, rezultoi e provuar se:

1. Nga verifikimi i kryer pranë *Regjistrit Kombëtar të Testamenteve*, dhe *Rregjistrit Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë*, nuk rezulton që Trashëgimlënësi të ketë lënë testament, apo të jetë lëshuar dëshmia e trashëgimisë.

2. Me vdekjen e Trashëgimlënësit, personat e interesuar, kërkueses i lind e drejta për të kërkuar nga Zyra e Noterisë Tiranë, lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë.

3. Referuar nenit 322, 333, të Kodit Civil, nuk rezulton që trashëgimtarët të jenë shpallur të padenjë apo të kenë hequr dorë nga trashëgimia.

4. Bazuar në Nenin 320 K.C, kanë zotësi për të trashëguar, personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë. Trashëgimtarë të tjerë që kërkon ligji nuk ka.

***Për këto arsye:***

*Bazuar* në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360, e vijues të Kodit Civil, dhe neni 62, pika 1, gërma d, nenet 111, 112, 113 e vijues te ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" I ndryshuar, *unë Noteri;*

A2022052670025415054

**VENDOSA:**

*1.Pranimin e Kërkesës;*

*2.Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për trashëgimlënësin* **ERVIN TERZIU,** me atësi Xhemali dhe amësi Fatbardha, me ID I160816051W *duke caktuar si Trashëgimtarë ligjorë të Rradhës së Parë ligjore, të cilët trashëgojnë të gjithë pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të drejtat reale dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi, në pjesë të barabartë dhe të pandarë nga 1/2 secili:*

***"Trashëgimtarë Ligjor të Trashëgimlënësit ERVIN TERZIU, me atësi Xhemali:"***

| | |
|---|---|
| *Bashkëshortja* | **VIOLA TERZIU,** me atësi Vasillaq, me ID I15514044D..............**1/2 Pjesë.** |
| *Djali* | **ANDRE TERZIU,** me atësi Ervin, me ID L31210063A..................**1/2Pjesë.** |

*Dëshmia Trashëgimisë, pamvarësisht rrethit të trashëgimtarve në çastin e rregjistrimit para institucionit përgjegjës për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës me 1/2pjesë.*

*Tiranë* 07.06.2022

**NOTER**
**TERENS N. KURTI**

*Kërkuesi, mori dijeni dhe merr persiper që brenda 30 ditëve duhet të depozitojë Dëshmine e Trashëgimisë në institucionin përgjegjës për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme.*
*Kërkuesi merr persipër të njoftoj trashëgimtarët e tjerë për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë.*
*Kjo dëshmi lëshohet në kopje originale, nga të cilat një kopje mbahet në arkivin noterial, nga një kopje u jepet trashëgimtarëve dhe një kopje dërgohet në institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*
*Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën Kompetente, në referim të nenit 97, pika 4 e ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë".*
*Unë, Noteri deklaroj se mora pëlqimin e Kërkuesit per përdorimin e të dhënave personale. Këto të dhëna jane konfidenciale dhe u përdorën vetëm për krijimin dhe redaktimin e këtij Akti, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale", i ndryshuar.*